



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Histori teatri dhe përkthimi i veprave teatrale

Ngarkesa në orë/kredite: 40 orë mësimore; 4 kredite; 20 leksione / 20 seminare
Viti / Semestri: Viti II, Semestri I/II
Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje
Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe interpretim në gjuhën greke dhe angleze”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Nëpërmjet këtij kursi studentëve u ofrohet njohuri e përgjithshme për dramaturgjinë dhe historinë e teatrit botëror. Studenti do të njihet me historinë e përmbledhur të teatrit dhe veprat më të spikatura të teatrit botëror. Historia e përkthimit të veprave letrare.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Përkthimi i dramës;
- 2.Përkthimi i komedisë;
- 3.Përkthimi i teatrit modern.

Rezultate të pritshme:

- 1.Të pajisë studentin me njohuritë bazë të historisë së teatrit dhe përkthimit të këtij lloji letrar, nëpërmjet shkrimtarëve të ndryshëm, vendeve, tendencave, shkollave dhe periudhave, duke nisur që nga Lashtësia e deri në ditët e sotme.
- 2.Synohet historia e kulturës së teatrit perëndimor. Secila temë do të shoqërohet edhe me hapësirën skenike, shfaqjet teatrale dhe tekstet përkatëse, dhe do të pasurohet me të dhëna historike në lidhje me to.
- 3.Në përgjithësi do të trajtohet koncepti i dramaturgjisë dhe historisë së përkthimit të veprave letrare